

LIGJ
Nr.7678, datë 3.3.1993

PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Akcizat janë tatime mbi një numër të kufizuar mallrash për konsum të brendshëm, pavarësisht nëse prodhohen brenda vendit apo importohen.

Neni 2

Personat juridikë a fizikë vendas dhe të huaj që i nënshtrohen këtij tatimi, janë prodhuesit dhe importuesit e mallrave të tatueshme me akcizë.

Neni 3

Mallrat që tatohen me akciza e përqindjet e tyre janë:

a.Duhan e prodhime duhani	Përqindja e akcizës
- Cigare	70
- Puro	70
- Duhan për konsum	70
- Letër cigare për shitje	50
b. Pije alkoolike	
- Birrë	40
- Verë	50
- Raki	60
- Konjak, uzo, fërnjet, ponç, uiski, rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike	70
- Likernat	50
c. Pije të buta dhe freskuese	30
ç. Ujë mineral (gline) dhe i gazuar	20
d. Energji elektrike	50
dh. Alkool importi për shitje	50
e. Alkool prodhim vendi për shitje	30

f. Nënproduktet e naftës:

- Benzinë 45-89.9 oktan	60
- Benzinë 90 oktan e lart	50
- Gazoil	40
- Vajguri	40
- Valvolinë	80
- Vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe graso	80
Të tjera (solar, mazut, koks nafte bitum, gaz i lëngët, toluol, squfur, ksilol, solvent)	25
(Me përjashtim të vajgurit, energjisë elektrike dhe gazit të lëngët që i shiten popullatës).	

Për letrën e cigares, të importuar nga subjektet e ndryshme ekonomike dhe që nevojitet për nevojat e prodhimit, të mos aplikohet akcizë në doganë.

Merret në formë akcize edhe diferenca midis çmimit përfundimtar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga organet shtetërore duke i shtuar këtij të fundit: për energjinë elektrike 50 për qind dhe për nënproduktet e naftës përqindjet e caktuara në nenin 3, shkronja "f".

Për mallrat e përcaktuara në pikën "a", kur importohen zbatohet një akcizë plus 30 për qind nga ajo e përmendur më lart dhe për ato të pikës "b", plus 15 për qind.

Neni 4

Për mallrat që prodhohen brenda vendit, akcizat llogariten në bazë të vlerës së çdo sasive malli të shitur dhe detyrimi për pagimin e tyre fillon nga koha kur shitësi nis faturën në drejtim të blerësit.

Shitësi e shton akcizën në vlerën e faturës dhe mbledh akcizën nga blerësi për llogari të buxhetit të shtetit.

Neni 5

Për mallrat që importohen, akcizat llogariten në bazë të vlerës doganore.

Neni 6

Organet doganore detyrohen të bëjnë llogaritjen dhe arkëtimin e akcizës për mallrat që importohen dhe shuma derdhet çdo 5 ditë në buxhetin e shtetit për llogari të organeve tatimore.

Neni 7

Për mallrat e importuara pagimi i akcizave bëhet njëherësh me pagimin e taksave doganore.

Neni 8

Për mallrat e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, kur kalojnë për eksport, nuk zbatohen akcizat.

Neni 9

Lëkurët dhe duhanet e papërpunuara, që eksportohen nga personat juridikë apo fizikë vendas dhe të huaj, për vitet 1993 e 1994 trajtohen me akcizë në masën 100 për qind të vlerës së tyre.

Neni 10

Akcizat derdhen në buxhetin e shtetit. Prodhuesit detyrohen t'i llogaritin e t'i derdhin në buxhet akcizat çdo 5 ditë.

Neni 11

Pagimi i akcizës bëhet vetëm një herë, nga importuesi ose prodhuesi i mallrave. Çdo shitje e mëtejshme me shumicë e mallrave të tatueshme me akcizë nuk i nënshtrohet pagimit të akcizës.

Neni 12

Prodhuesit e importuesit e mallrave që tatohen me akcizat dhe organet doganore detyrohen të mbajnë llogari të veçantë, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore për akcizat e realizuara e të derdhura, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 13

Konsiderohet shkelje e këtij Ligji:

- Fshehja e falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e akcizave.
- Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël për akcizat.
- Derdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit.
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara.

Neni 14

Shkeljet e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, pavarësisht nëse përbën vepër penale, dënohen edhe me këto masa:

- Fshehja e falsifikimi i akcizave me gjobë në masën 5 fish të shumës së akcizës të fshehur ose falsifikuar dhe me marrjen 100 për qind të akcizës së fshehur ose të falsifikuar.
- Mbajta e gabuar e llogarive kontabël me gjobë nga 5000 deri në 10000 lekë.
- Derdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit, me gjobë 5000 lekë dhe me kamatvonesë në masën 0.10 për qind për çdo ditë vonese.
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara me gjobë 2000 deri në 6000 lekë.

Neni 15

Ligji nr.7547, datë 6.1.1992 ndryshuar me ligjin nr.7586, datë 14.7.1992 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë " si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.483, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.